

Udhëzues përdorimi  
për aparatin e dëgjimit  
AQ beat ST R



**HANSATON**  
*hearing & emotions*

Ky udhëzues përdorimi vlen për të gjithë modelet e mëposhtme

### **Aparatet e dëgjimit**

**CE**  
**0459**

AQ beat ST 9-R	2021
AQ beat ST 7-R	2021
AQ beat ST 5-R	2021
AQ beat ST 3-R	2021
AQ beat ST 1-R*	2021
AQ beat ST myChoice	2021

### **Aksesori i karikimit me Aksesor karikimi me valë**

**CE**

Karikuesi HANSATON	2019
--------------------	------

\*Nuk është i disponueshëm në të gjitha tregjet.





## Aparatet tuaja të dëgjimit

---

Specialisti audiolog: \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Telefoni: \_\_\_\_\_

Modeli: \_\_\_\_\_

Numri serial: \_\_\_\_\_

Garancia: \_\_\_\_\_

Programi 1 është për: \_\_\_\_\_

Programi 2 është për: \_\_\_\_\_

Programi 3 është për: \_\_\_\_\_

Programi 4 është për: \_\_\_\_\_

Data e blerjes: \_\_\_\_\_

## Referencë e shpejtë

Paralajmërimi për  
rënien e baterisë



2 sinjale çdo  
30 minuta

Butoni shumëfunktional  
me dritë treguese



### Ndezja/fikja e aparatit të dëgjimit

Shtypni e mbani pjesën e poshtme të butonit në secilën njësi të aparatit të dëgjimit për 3 sekonda derisa të ndryshojnë dritat treguese.

**Ndezja:** Drita treguese është  
përkohësisht jeshile e  
qëndrueshme



Ndezja



Fikja

**Fikja:** Drita treguese është  
përkohësisht e kuqe e  
qëndrueshme


**i** Përpapa përdorimit të aparatit të dëgjimit për herë të parë rekomandohet ta karikoni për 3 orë.

### Karikimi i aparatit të dëgjimit

Vendoseni aparatit e dëgjimit mirë në  
karikues. Shikoni nëse dritat po pulsojnë  
për të konfirmuar që aparati i dëgjimit po  
karikohet.

**Karikimi:** Dritë treguese me  
pulsim të ngadaltë

**I karikuar tërësisht:** Drita treguese jeshile  
e qëndrueshme








Faleminderit që keni zgjedhur këto aparate dëgjimi.

Lexoni me kujdes udhëzuesin e përdorimit për t'u siguruar që t'i kuptoni dhe të përfitoni sa më shumë nga pajisjet tuaja të dëgjimit. Për manovrimin e kësaj pajisjeje nuk kërkohet ndonjë trajnim. Specialisti juaj audiolog do t'ju ndihmojë për konfigurimin e aparatit të dëgjimit sipas preferencave tuaja individuale.

Për më shumë informacione në lidhje me veçoritë, përfitimet, konfigurimin, përdorimin dhe mirëmbajtjen ose riparimet e pajisjes së dëgjimit dhe aksesorëve të saj, kontaktoni me specialistin tuaj audiolog ose me përfaqësuesin e prodhuesit. Informacione të mëtejshme mund të gjenden në skedën e specifikimeve të produktit tuaj.









# Pasqyra e lëndës

---

1. Aparati juaj i dëgjimit me një vështrim të shpejtë.....	2
2. Ndezja dhe fikja e aparatit .....	5
3. Vendosja e aparatit të dëgjimit në veshë .....	6
4. Udhëzimet e përdorimit .....	8
Aparati juaj i rikarikueshëm i dëgjimit.....	12
Karikimi i aparatit të dëgjimit.....	14
Çiftimi i celularit me aparatën e dëgjimit .....	19
Përdorimi i celularit me aparatën e dëgjimit.....	22
TV Connector .....	27
Tinnitus Masker.....	28
Modaliteti i fluturimit .....	29
5. Mirëmbajtja e aparatit të dëgjimit.....	30
6. Aksesorët .....	34
7. Manuali i problemeve .....	36
8. Informacione të rëndësishme për sigurinë.....	43
9. Kushtet për përdorimin, transportin dhe ruajtjen .....	66
10. Informacion dhe shpjegimi i simboleve .....	67
11. Informacioni i pajtueshmërisë.....	71



## 1. Aparati juaj i dëgjimit me një vështrim të shpejtë

---

- 1 Butoni shumëfunksional me dritën treguese - ndërron mes programeve të dëgjimit, ndryshon nivelin e volumit dhe pranon ose refuzon telefonatat e celularit në varësi të konfigurimit tuaj të personalizuar
- 2 Mikrofofi - tingulli hyn në aparatën e dëgjimit nëpërmjet mikrofonave. Mbrojtësi i mikrofonit - mbron mikrofonin nga pluhuri dhe copat
- 3 Kapësja e harkuar - pjesa hyrëse e personalizuar lidhet me aparatën e dëgjimit duke përdorur kapësen
- 4 Tubi plastik - pjesa e formës së personalizuar që lidhet me kapësen e harkuar
- 5 Forma e personalizuar - lejon tingullin të kalojë nga aparatet e dëgjimit te veshi dhe mban aparatet në pozicionin e duhur
- 6 Gypi i hollë - tingulli udhëton përmes gypit të hollë në kanalën e veshit
- 7 Koka - mban gypin e hollë në kanalën e veshit tuaj
- 8 Aksesori mbajtës - ndihmon për parandalimin e daljes së gominës dhe të njësisë së altoparantit nga kanali i veshit

2






## Aparati i dëgjimit AQ beat ST R BTE



3




## Karikuesi



## 2. Ndezja dhe fikja e aparatit


Aparati juaj i dëgjimit do të ndizet automatikisht kur të hiqet nga karikuesi. Për të ndezur e fikur aparatin e dëgjimit kur nuk e përdorni karikuesin, shtypni e mbani pjesën e poshtme të butonit në secilën njësi të aparatit të dëgjimit për 3 sekonda derisa të ndryshojnë dritat treguese.



**Ndezja:** Drita treguese është për kohësisht jeshile e qëndrueshme



Ndezja



Fikja

**Fikja:** Drita treguese është për kohësisht e kuqe e qëndrueshme




- ① Përpara përdorimit të aparatit të dëgjimit për herë të parë rekomandohet ta karikoni për 3 orë.
- ① Kur e ndizni aparatin e dëgjimit mund të dëgjoni një melodi të nisjes.

### 3. Vendosja e aparatit të dëgjimit në veshë

Aparati i dëgjimit vjen i shënuar me ngjyra në pjesën e jashtme: e kuqe = veshi i djathtë; e kaltër = veshi i majtë.




Aparati i dëgjimit me gomina

1. Vendoseni aparatin e dëgjimit përmbi vesh.
2. Mbajeni gypin e hollë aty ku vendoset te gomina kupë dhe shtypeni lehtë kupëzën në kanal in e veshit. Gypin duhet të jetë i mbështetur në kokën tuaj dhe jo të ketë hapsirë ndërm, jet tyre.
3. Nëse ka një pjesë mbajtëse, ajo duhet të qëndroj në pjesën hyrëse të kanalit të veshit. kanalit.



## Aparatet me forma të personalizuara

1. Mbajeni formën e personalizuar mes gishtit të madh dhe atij tregues. Ajo duhet të jetë e drejtuar nga kanali i veshit me aparatën e dëgjimit të vendosur mbi veshin tuaj.
2. Futeni me kujdes formën e personalizuar në vesh. Mund të jetë e nevojshme ta lëvizni për të gjetur pozicionin e duhur. Forma e personalizuar duhet të përshtatet mirë dhe lehtë. Tërhiqni me kujdes llapen e veshit poshtë dhe prapa për t'ju ndihmuar ta futni me më shumë lehtësi formën e personalizuar në kanalën e veshit.
3. Vendoseni aparatën e dëgjimit përmbi vesh.



### Etiketimi


Numri serial dhe viti i prodhimit ndodhen nën shënimin me ngjyrë të aparatit.

## 4. Udhëzimet e përdorimit

Aparati juaj i dëgjimit vjen me një buton shumëfunktional që ju mundëson rregullimin e mëtejshëm të tyre. Butonin shumëfunktional mund ta përdorni dhe për të marrë dhe refuzuar telefonata në celularin e çiftuar. Mund të përdorni po ashtu telekomandën opsionale Remote Control ose aplikacionin "stream remote" për të kontrolluar aparatet e dëgjimit.

- ① Këto udhëzime përshkruajnë parametrat e parazgjedhur të butonit shumëfunktional Specialisti audiolog mund ta ndryshojë funksionin e butonave. Konsultohuni me specialistin audiolog për më shumë informacione.

### Butoni shumëfunktional



Butoni shumëfunktional në aparatën e dëgjimit mund të përdoret si për komandën e volumnit, ashtu edhe të programeve.

## □ Komanda e programeve

Sa herë që shtypni pjesën e sipërme të butonit në aparatit e dëgjimit mbi 2 sekonda, do të kaloni në programin vijues të aparatit të dëgjimit.

Tingujt në aparat tregojnë se në cilin program jeni.

Cilësimi i programit	Tingujt "bip"
Programi 1 (p.sh. program automatik)	♪ 1 bip
Programi 2 (p.sh. të folurit në zhurmë)	♪♪ 2 bipe
Programi 3 (p.sh. telefon)	♪♪♪ 3 tinguj
Programi 4 (p.sh. muzika)	♪♪♪♪ 4 tinguj

Shikoni kopertinën e kësaj broshure për një listë të programeve tuaja të personalizuara.

## Kontrolli i volumit

Për të ndryshuar volumin në ambientin tuaj:

- Shtypni pjesën e sipërme të butonit të aparatit të dëgjimit për të rritur volumin, dhe
- Shtypni pjesën e poshtme të butonit të aparatit të dëgjimit, për të ulur volumin

Kur ndryshoni volumin, aparati i dëgjimit jep një tingull "bip".


Vendosja e volumit	Tingujt "bip"
Volumi i sugjeruar	♪ 1 bip
Ngritja e volumit	♪ bip i shkurtër
Ulja e volumit	♪ bip i shkurtër
Volumi maksimal	♪♪ 2 bipe
Volumi minimal	♪♪ 2 bipe



## Kontrolli me shtypje

Nëse aparatin e çiftoni me një pajisje me **Bluetooth®**, butonin shumëfunksional mund ta përdorni edhe për shumë funksione si p.sh. pranoni/mbyllni telefonatat, vendosni në pauzë/vazhdoni transmetimin, nisni/ndaloni asistentin zanor.

Për të përdorur kontrollin me prekje, shtypni dy herë mbi veshin tuaj.



Bluetooth® është një markë tregtare e regjistruar në pronësi të Bluetooth SIG, Inc.

## Aparati juaj i rikarikueshëm i dëgjimit

### Informacioni i baterisë

- ① Përpara përdorimit të aparatit të dëgjimit për herë të parë rekomandohet ta karikoni për 3 orë.
- ① Këto aparate dëgjimi përfshijnë një bateri të rikarikueshme të integruar dhe që nuk hiqet me jone litiumi.

Dy tinguj të gjatë tregojnë se bateria e aparatit është në nivel të ulët. Keni rreth 60 minuta përpara se t'ju duhet ta karikoni aparatin e dëgjimit (kjo mund të ndryshojë në varësi të cilësimeve të aparatit të dëgjimit).


Nëse nuk e dëgjoni paralajmërimin për rënien e baterisë, specialisti audiolog mund të ndryshojë frekuencën ose volumin. Nëse dëshironi, mund dhe ta fikni fare.

## Informacion për karikimin

- ① Aparati i dëgjimit duhet të jetë i thatë përpara vendosjes në karikim.
- ① Karikojeni çdo natë aparatin e dëgjimit. Nëse dëgjoni paralajmërimin e rënies së baterisë, vendoseni aparatin e dëgjimit në karikues.
- ① Sigurohuni ta karikoni dhe përdorni aparatin e dëgjimit brenda diapazonit të temperaturës së punës: +5° deri +40° Celsius (41° deri 104° fahrenheit).
- ① Nëse karikuesi hiqet nga burimi i energjisë gjatë karikimit, aparati i dëgjimit do të ndizet dhe do të fillojë të shkarkohet. Sigurohuni që karikuesi të qëndrojë i lidhur me energjinë elektrike kur aparati i dëgjimit është te karikuesi.

## Karikimi i aparatit të dëgjimit

### 1) Lidhja e ushqyesit



- Vendosni skajin më të madh të kordonit të karikimit tek ushqyesi.
- Vendosni skajin më të vogël në folenë USB-C të karikuesit.
- Vendoseni ushqyesin në prizë.
- Drita treguese është e gjelbër kur karikuesit lidhet me ushqyesin.

## Specifikimet elektrike të ushqyesit

Voltazhi dalës i furnizimit me energji 5 VDC +/-10%, rryma 1 A


Voltazhi hyrës i furnizimit me energji 100-240 VAC, 50/60 Hz, rryma 0,25 A

Voltazhi hyrës i karikuesit 5 VDC +/-10%, rryma 500 mA

Specifikimet e kabllës USB 5 V min. 1 A, USB-A në USB-C, gjatësia maksimale 3 m


## 2) Futni aparatin e dëgjimit

Futni mirë njësitë e aparatit të dëgjimit në foletë e karikimit. Sigurohuni që shënimet e majta dhe të djathta të aparatit të dëgjimit të përkojnë me treguesit e majtë (blu)/e djathtë (i kuq) në krah të foleve të karikimit. Aparati i dëgjimit do të fiket automatikisht kur futet në karikues.



### 3) Shikoni dritën treguese





Drita treguese do të pulsojë me ngadalë derisa aparati i dëgjimit të jetë karikuar plotësisht. Pasi të karikohet plotësisht, drita treguese do të qëndrojë në të gjelbër konstante.



Procesi i karikimit ndalon automatikisht pas karikimit të plotë të baterive, kështu që aparati i dëgjimit mund të lihet pa problem në karikues. Mund të nevojiten deri në 3 orë për karikimin e plotë të aparatit të dëgjimit. Kapaku i karikimit mund të mbyllet gjatë karikimit.


## Kuptimi i dritës treguese

Në tabelën e mëposhtme tregohet koha e karikimit për baterinë plotësisht të shkarkuar.

Drita treguese	Përqindja e karikimit	Koha e karikimit
	0-10%	
	11-80%	30 min (30%) 60 min (50%) 90 min (80%)
	81-99%	
	100%	3 orë

4) Hiqni aparatin e dëgjimit nga karikuesi  
Hiqni aparatet e dëgjimit nga foletë e karikimit  
duke i tërhequr dhe drejt pjesës së përparme të  
karikuesit për t'i ndezur.

- ① Mos tërhiqni tubat për ta hequr aparatin e dëgjimit nga karikuesi, pasi mund të dëmtoni tubat.









## Çiftimi i celularit me aparatën e dëgjimit

---

1. Në celular, shkoni te menyja e cilësimeve për t'u siguruar që keni aktivizuar **Bluetooth**<sup>®</sup> dhe për të kërkuar për pajisje që mund të lidhen me "Bluetooth".
  2. Ndizni aparatën e dëgjimit. Aparati juaj i dëgjimit do të qëndrojë në modalitet çiftimi për 3 minuta.
  3. Celulari do të nxjerrë një listë të pajisjeve të gjetura që mund të lidhen me "Bluetooth". Zgjidhni aparatën tuaj të dëgjimit nga lista dhe çiftojini njëherësh të dyja njësitë e aparatit. Do të dëgjoni një melodi pasi celulari të çiftohet me sukses me aparatën e dëgjimit.
- ① Procedurën e çiftimit mjafton ta kryeni vetëm një herë me çdo celular që lidhet me anë të "Bluetooth".
  - ① Konsultohuni me manualin e celularit për udhëzime mbi çiftimin e tij me pajisje me "Bluetooth".
- 
- 

Bluetooth<sup>®</sup> është një markë tregtare e regjistruar në pronësi të Bluetooth SIG, Inc.

## Lidhja me celularin


Pasi ta keni çiftuar aparatin e dëgjimit me celularin, këta do të lidhen vetiu në vijim kur celulari dhe aparati i dëgjimit të jenë të ndezur dhe brenda rrezes. Kjo mund marrë deri në 2 minuta.

- ① Lidhja do të ruhet për sa kohë që telefoni qëndron i ndezur dhe brenda një rrezeje prej deri në 10 m (30 ft).
- ① Për të përcjellë telefonatën midis aparatis të dëgjimit dhe altoparantis të celularit, zgjidhni burimin e audios që dëshironi nga celulari. Nëse nuk jeni të sigurt se si ta kryeni veprimin, shihni manualin e përdorimit që keni marrë me celularin.

## Telefonatat me celular

Aparati i dëgjimit lejon komunikim të drejtpërdrejtë me celularët që mbështesin lidhjen me Bluetooth. Kur është i çiftuar dhe i lidhur me një celular, do ta dëgjoni zërin e telefonuesit direkt në aparatin e dëgjimit. Aparati juaj i dëgjimit e merr zërin tuaj përmes mikrofonave të vet. Dy pajisje me Bluetooth-in të aktivizuar, si p.sh. një telefon, mund të lidhen me pajisjen e dëgjimit, me mbështetjen për çiftime të tjera.

- ① Nuk ka nevojë ta mbani celularin pranë gojës, zëri juaj përcillet nga aparati i dëgjimit drejt celularit.





## Përdorimi i celularit me aparatit e dëgjimit

---

### Kryerja e telefonatave

Niseni telefonatën në celularin e çiftuar siç do ta bënit normalisht. Audion do ta dëgjoni përmes aparatit të dëgjimit. Aparati juaj i dëgjimit e merr zërin tuaj përmes mikrofonave të vet.



## Marrja e telefonatave të celularit

Kur merrni një telefonatë, do të dëgjoni njoftimit e mbërritjes së telefonatës në aparatin e dëgjimit.

Telefonata mund të pranohet duke prekur dy herë mbi veshin tuaj, ose me një shtypje të shkurtër prej më pak se 2 sekondash në pjesën e sipërme ose të poshtme të butonit në cilëndo njësi të aparatit të dëgjimit. Përndryshe, pranojeni telefonatën në celular si normalisht.



## Mbyllja e telefonatave

Telefonatën mund ta mbyllni duke prekur dy herë mbi veshin tuaj, ose duke mbajtur të shtypur për më shumë se 2 sekonda pjesën e sipërme ose të poshtme të butonit në cilëndo njësi të aparatit të dëgjimit. Përndryshe, mbylleni telefonatën në celular si normalisht.





## Refuzimi i telefonatave


Telefonatën në mbërritje mund ta refuzoni duke mbajtur të shtypur për mbi 2 sekonda pjesën e sipërme ose të poshtme të butonit në cilëndo njësi të aparatit të dëgjimit. Përndryshe, refuzojeni telefonatën në celular si normalisht.



Ndryshimi i ekuilibrit të volumit midis telefonatave të celularit dhe ambientit ku ndodheni

Gjatë një telefonate me celular të çiftuar:

- Shtypni pjesën e sipërme të butonit të aparatit të dëgjimit për të rritur volumin e telefonatës dhe për të ulur volumin e zhurmës së ambientit
- Shtypni pjesën e poshtme të butonit të aparatit të dëgjimit për të ulur volumin e telefonatës dhe për të rritur volumin e zhurmës së ambientit






## TV Connector

Ndryshimi i ekuilibrit të volumit midis televizorit dhe zhurmës së ambientit

Kur dëgjoni zërin e televizorit nëpërmjet aksesorit të bashkuesit të televizorit:

- Shtypni pjesën e sipërme të butonit të aparatit të dëgjimit për të rritur volumin e televizorit dhe për të ulur volumin e zhurmës së ambientit
- Shtypni pjesën e poshtme të butonit të aparatit të dëgjimit për të ulur volumin e televizorit dhe për të rritur volumin e zhurmës së ambientit







## Tinnitus Masker

---

Nëse specialisti audiolog ju ka konfiguruar një program "Tinnitus Masker," mund ta ndryshoni nivelin e këtij kur ndodheni në programin "Tinnitus Masker." Për të ndryshuar nivelin e zhurmës:

- Shtypni pjesën e sipërme të butonit të aparatit të dëgjimit, për të rritur "Tinnitus Masker," dhe
- Shtypni pjesën e poshtme të butonit të aparatit të dëgjimit, për të ulur "Tinnitus Masker"

Aplikacioni "stream remote":

- 
- Trokitni te butoni i parametrave të përparuar ku mund të rregulloni rritjen ose uljen e volumit për "tinnitus masker"
- 

Kur ndryshoni nivelin, aparati i dëgjimit jep një tingull "bip".




## Modaliteti i fluturimit

Aparati juaj i dëgjimit funksionon në diapazon frekuencash 2,4–2,48 GHz. Kur jeni në fluturim, disa linja ajrore kërkojnë që të gjitha pajisjet të caktohen në modalitetin e fluturimit. Vendosja në modalitet fluturimi nuk e çaktivizon funksionin normal të aparatit të dëgjimit, por vetëm funksionet e lidhjes me "Bluetooth".

### Aktivizimi i modalitetit të fluturimit

Për të çaktivizuar funksionin e lidhjes me valë "Bluetooth" dhe vendosjen e modalitetit të fluturimit:


Kur aparati i dëgjimit është i fikur, shtypni e mbani pjesën e poshtme të butonit për 7 sekonda derisa të shfaqet drita konstante e portokalltë. Pastaj lëshojeni butonin.



### Çaktivizimi i modalitetit të fluturimit

Për të aktivizuar funksionin e lidhjes me valë "Bluetooth" dhe daljen nga modaliteti i fluturimit:

Fikeni dhe rindizeni aparatin e dëgjimit duke përdorur pjesën e poshtme të butonit të aparatit.





## 5. Mirëmbajtja e aparatit të dëgjimit

### Mbrojtja e aparatit të dëgjimit

- Kujdesi i duhur dhe i rregullt për aparatin e dëgjimit dhe karikuesin tuaj ndihmojnë për një cilësi funksionimi të shkëlqyer dhe një jetëgjatësi të madhe shërbimi. Për të siguruar një jetëgjatësi të madhe shërbimi, Sonova AG siguron një periudhë shërbimi për pesë vite pas ndërprerjes së prodhimit të një aparati dëgjimi përkatës.
- Hiqeni gjithnjë aparatin e dëgjimit kur përdorni artikuj për flokët. Aparati i dëgjimit mund të bllokohet dhe të pushojë së funksionuari siç duhet.
- Mos e mbani aparatin e dëgjimit në banjë apo në dush, dhe mos e zhysni në ujë.
- Nëse aparati i dëgjimit laget, mos u përpiqni ta thani në furrë apo në mikrovalë. Mos ia ndryshoni komandat.
- Mbrojeni aparatin e dëgjimit nga nxehtësia e tepërt (p.sh. tharëse flokësh, xhep apo kruskot automat).  
• Sigurohuni të mos i përdridhni apo shtypni tubat kur e mbani aparatin e dëgjimit në kutinë e vet.

30





- Mos e rrezoni aparatin e dëgjimit dhe mos e përplasni në sipërfaqe të forta.

### Pastrimi i aparatit të dëgjimit

Përdorni në leckë të butë për pastrimin e aparatit të dëgjimit në fund të çdo dite. Pastrimi i rregullt i foleve të mikrofonit me furçën e dhënë të pastrimit do të sigurojë ruajtjen e cilësisë së zërit të aparatit. Specialisti audiolog mund t'ju tregojë se si ta bëni diçka të tillë. Vendoseni aparatin e dëgjimit në karikues gjatë natës.

- ① Dylli i veshëve është i natyrshëm dhe i zakonshëm. Kujdesi që ta mbani aparatin e dëgjimit pa dyllë veshës është një hap i rëndësishëm në rutinën tuaj ditore të pastrim-mirëmbajtjes.
- ① Mos përdorni kurrë alkool për pastrimin e aparatit të dëgjimit, kufjeve-kallëp apo kufjeve-tapë.
- ① Mos përdorni mjete të mprehta për heqjen e dyllit të veshëve. Futja e sendeve shtëpiake në aparatin e dëgjimit apo në format e personalizuara mund t'i dëmtojë rëndë.



Pastrimi i tubave të hollë dhe gominave

Gypat e hollë dhe kokat e masave të veshit duhet të vendosen nga personi përgjegjës për afërsisht tre deri në gjashtë muaj ose kur ato të bëhen të forta, të brishta, ose pangjyrë.



Pastroni pjesën e jashtme të gominës në fund të çdo dite me një leckë të lagësht. Shmangni futjen e ujit rreth dhe në aparate.


Gjithashtu duhet të pastroni gypat e hollë, me pastruesen e ofruar, kur të filloni të vëreni copëza brenda dhe rreth gypave.

1. Mbani gypin e hollë në një dorë dhe aparatën në dorën tjetër.
2. Butësisht rrotulloni aparatën derisa të shkëputet nga gypi i hollë.
3. Përdorni një leckë të lagur për të pastruar pjesën e jashtme të tubit të hollë dhe të gominës.
4. Hiqeni gominën nga tubi i hollë duke e tërhequr lehtë, para pastrimit të tubit të hollë.





5. Përdorimi i pastrueses së zeze ofruar me aparatet, butësisht vendoseni pastruesen aty ku gypi i hollë vendoset në aparat dhe shtyje pastruesen deri në fund të gypit.



- ① Shënim: Tubat e hollë dhe gominat nuk duhet të shpëlahen apo zhyten kurrë në ujë, pasi pikat e ujit mund të bllokojnë tubin, zërin ose të dëmtojnë komponentët elektrikë të aparatit të dëgjimit.
6. Pasi të pastrohet gypi i hollë, rivendoseni duke e rrotulluar aparatin ngadalë në gypin e hollë.
7. Rivendosni gominën në tubin e hollë duke e shtyrë ngadalë deri në fund të tubit. Do të ndjeni kërcitjen e gominës në pjesën e dalë të tubit të hollë dhe nuk do të keni mundësi ta shtyni më shumë.





## 6. Aksesorët


---

### TV Connector


TV Connector është një aksesor optik që e dërgon zërin e televizorit direkt tek aparati i dëgjimit.

TV Connector mund të përcjellë dhe zërin e sistemeve stereo, kompjuterëve dhe burimeve të tjera zanore.

### Remote Control



Telekomanda Remote Control është një aksesor opsional që mund të përdoret për të kontrolluar nivelin e volumit dhe ndryshimet e programit në aparatin e dëgjimit.



### PartnerMic

PartnerMic është një aksesor opsional që mund të përdoret për të transmetuar zërin e personit që flet me anë të valëve tek aparati juaj i dëgjimit.

### RogerDirect™


Aparati juaj i dëgjimit është në përputhje me aksesorët Roger.™ Aksesorët Roger mund të përdoren për të transmetuar një zë ose burim zëri me anë të valëve tek aparati juaj i dëgjimit.





## Pasqyra e lidhjeve

Ilustrimi më poshtë tregon disa nga opsionet e lidhjeve që ofrohen për aparatin tuaj të dëgjimit.



Për më shumë informacione, shikoni udhëzuesin e përdorimit që vjen me aksesoren tuaj. Kontaktoni me specialistin audiolog për të marrë një TV Connector, Remote Control ose aksesorë PartnerMic ose Roger.

## 7. Manuali i problemeve

Shkaku

Masa e mundshme

Problemi: nuk ndizet

Ka mbaruar bateria

Vendoseni aparatin e dëgjimit në karikues të vendosur në prizë

Problemi: drita treguese pulson me të shpejtë gjatë karikimit

Bateria ka problem

Konsultohuni me specialistin audiolog

Problemi: drita treguese rri fikur kur vendoset në karikues

Aparati i dëgjimit nuk është vendosur siç duhet në karikues

Vendoseni mirë aparatin e dëgjimit në karikues, shihni "Karikimi i aparatit të dëgjimit"

Karikuesi nuk është lidhur me një burim energjie

Futeni karikuesin në prizë, shihni "Karikimi i aparatit të dëgjimit"



## Shkaku

## Masa e mundshme

Problemi: bateria nuk zgjat gjithë ditën

Aparati i dëgjimit nuk është karikuar plotësisht

Vendoseni aparatin e dëgjimit në karikues të vendosur në prizë

Duhet ndërruar bateria

Konsultohuni me specialistin audiolog për të parë nëse nevojitet ndërimi i baterisë

Problemi: nuk ka zë

Nuk është ndezur

Ndizeni

Ka rënë/mbaruar bateria

Vendoseni aparatin e dëgjimit në karikues të vendosur në prizë

Gominat/format e personalizuar janë bllokuar me dyllë veshësh

Pastroni gominat/format e personalizuar. Shihni "Pastrimi i aparatit të dëgjimit". Konsultohuni me specialistin audiolog

Blokim i mikrofonave

Konsultohuni me specialistin audiolog

## Shkaku

## Masa e mundshme

Problemi: nuk dëgjohet mjaftueshëm

Volum i ulët

Ngrini volumin; kryeni një vizitë me specialistin audiolog nëse problemi vazhdon

Ka rënë bateria

Vendoseni aparatën e dëgjimit në karikues të vendosur në prizë

Gominat/format e personalizuar nuk janë futur siç duhet

Shikoni "3. Vendosja e aparatit të dëgjimit në veshët tuaj".  
Hiqeni dhe rivendoseni siç duhet

Ndryshim në dëgjim

Konsultohuni me specialistin audiolog

Gominat/format e personalizuar janë bllokuar me dyllë veshësh

Pastroni gominat/format e personalizuar. Shihni "Pastrimi i aparatit të dëgjimit".  
Konsultohuni me specialistin audiolog

Shtuposje e mikrofonave

Konsultohuni me specialistin audiolog

## Shkaku

## Masa e mundshme

Problemi: zë me ndërprerje

Ka rënë bateria

Vendoseni aparatën e dëgjimit në karikues të vendosur në prizë

Problemi: dy tinguj të gjatë "bip"

Ka rënë bateria

Vendoseni aparatën e dëgjimit në karikues të vendosur në prizë

Problemi: fishkëllima

Gominat/format e personalizuar nuk janë futur siç duhet

Shikoni "3. Vendosja e aparatit të dëgjimit në veshët tuaj." Hiqeni dhe rivendoseni siç duhet

Ka dorë/veshje pranë veshit

Largoni dorën/veshjet nga veshi

Gominat/format e personalizuar nuk rrinë mirë

Konsultohuni me specialistin audiolog



## Shkaku

## Masa e mundshme

Problemi: paqartësi, shtrembërim

Gominat/format e personalizuara nuk rrinë mirë

Konsultohuni me specialistin audiolog

Gominat/format e personalizuara janë bllokuar me dyllë veshësh

Pastroni gominat/format e personalizuara. Shihni "Pastrimi i aparatit të dëgjimit" Konsultohuni me specialistin audiolog

Ka rënë bateria

Vendoseni aparatin e dëgjimit në karikues të vendosur në prizë

Shtuposje e mikrofonave

Konsultohuni me specialistin audiolog

Problemi: Gominat/format e personalizuara bien nga veshi

Gominat/format e personalizuara nuk rrinë mirë

Konsultohuni me specialistin audiolog

Gominat/format e personalizuara nuk janë futur siç duhet

Shikoni "3. Vendosja e aparatit të dëgjimit në veshët tuaj" Hiqeni dhe rivendoseni siç duhet





## Shkaku

## Masa e mundshme

Problemi: volum i ulët në telefonat fiks

Telefoni nuk mbahet siç duhet

Silleni receptorin e telefonit rotull veshit për sinjal më të pastër

Aparati i dëgjimit ka nevojë për kalibrim

Konsultohuni me specialistin audiolog

Problemi: telefonatat e celularit nuk dëgjohen në aparatin e dëgjimit

Aparati i dëgjimit është në modalitet fluturimi

Fikeni dhe rindizeni aparatin e dëgjimit

Aparati i dëgjimit nuk është i çiftuar me celularin

Çiftojeni aparatin e dëgjimit me celularin (sërish)

Problemi: dritat treguese në aparatin e dëgjimit rrinë në të kuqe konstante kur vendoset në karikues

Aparati i dëgjimit është jashtë diapazonit të temperaturave të punës

Sigurohuni që aparati i dëgjimit të jetë brenda diapazonit të temperaturave të punës +5° deri në +40° celsius (41° deri në 104° fahrenheit)



Shkaku	Masa e mundshme
Problemi: karikimi nuk fillon	
Karikuesi nuk është futur në prizë	Futeni karikuesin në prizë
Aparati i dëgjimit nuk është vendosur siç duhet në karikues	Vendoseni mirë aparatin e dëgjimit në karikues, shihni "Karikimi i aparatit të dëgjimit"
Aparati i dëgjimit nuk ndriçon kur e vendosni në karikues	Hiqeni karikuesin nga priza me aparatin e dëgjimit të futur dhe vendoseni përsëri karikuesin në prizë
Kontaktet e karikimit nuk janë të pastra	Pastroni kontaktet e karikimit duke përdorur një pecetë ose furçë pastrimi



Për ndonjë problem që nuk është i shkruar në udhëzues, kontaktoni me specialistin audiolog.







## 8. Informacione të rëndësishme për sigurinë

---

Lexoni informacionet përkatëse të sigurisë dhe informacionet për kufizimet e përdorimit para se të përdorni aparatit tuaj të dëgjimit.

### Përdorimi i planifikuar

Aparati i dëgjimit ka për qëllim amplifikimin dhe përcimin e zërit drejt veshëve, duke kompensuar kështu mungesen apo problemin e dëgjimit.

Karikuesi është një aksesori për një pajisje mjekësore dhe nuk ka përdorim terapeutik apo diagnostikues më vete. Ai është planifikuar për rikarikimin e aparatit të rikarikueshëm të dëgjimit.

Veçoria Tinnitus është planifikuar për përdorim nga personat që kanë tinitus dhe që dëshirojnë amplifikimin e zërit. Ajo siguron një stimulim plotësues të zhurmës që mund të ndihmojë për shpërqendrimin e vëmendjes së përdoruesit nga tinitusi.

### Indikacionet

Indikacionet e përgjithshme klinike për përdorimin e aparateve të dëgjimit dhe veçorisë



Tinnitus janë:

- Prania e humbjes së dëgjimit
- Në një ose dy anë
- Konduktive, sensore-neurale ose e përzier
- E lehtë deri në e thellë
- Prania e tinitusit kronik (e vlefshme vetëm për pajisjet që sigurojnë veçorinë Tinnitus).

### Kontraindikacionet

Kontraindikacionet e përgjithshme klinike për përdorimin e aparateve të dëgjimit dhe softuerit Tinnitus janë:

- Humbja e dëgjimit nuk është në diapazonin e aparatit të dëgjimit (d.m.th. mbulimi, përfshirja e të gjithë games frekuenciale)
- Tinitus akut
- Deformimi i veshit (d.m.th. kanali i veshit i mbyllur; mungesa e aurikulës)
- Humbja neurale e dëgjimit (patologjitë retrokokleare si p.sh. mungesa/mosfunksionimi i nervit të dëgjimit)

Kriteri kryesor për rekomandimin e një pacienti për një opinion mjekësor ose nga një specialist tjetër dhe/ose trajtimin janë si më poshtë:



- Deformim i dukshëm nga lindja ose traumatike e veshit.
- Histori e rrjedhjeve aktive nga veshi brenda 90 ditëve të kaluara;
- Histori e humbjes së papritur ose me progres të shpejtë të dëgjimit në një ose në të dy veshët brenda 90 ditëve të kaluara;
- Marramendje akute ose kronike;
- Diferencë audiometrik ajror i barabartë ose më i madh se 15 dB në 500 Hz, 1000 Hz dhe 2000 Hz;
- Dëshmi e dukshme e grumbullimit të konsiderueshëm të dyllit të veshit ose një trupi të huaj në kanalin e veshit;
- Dhimbje ose shqetësim në vesh;
- Pamje jonormale e daullës së veshit dhe kanalit të veshit si p.sh.:
  - Inflamacion i kanalit të jashtëm të dëgjimit,
  - Daullja e veshit e shpuar;
  - Anomali të tjera që specialisti audiolog beson se janë shqetësuese në aspektin mjekësor.





Specialist audiolog mund të vendosë që nuk nevojitet një rekomandim ose në interesin më të mirë të pacientit në situatat e mëposhtme:

- Kur ka prova të mjaftueshme se gjendja është ekzaminuar plotësisht nga një specialist mjekësor dhe është dhënë çdo trajtim i mundshëm;
- Gjendja nuk është përkeqësuar apo nuk ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme që nga ekzaminimi dhe/ose trajtimi i mëparshëm.

Nëse pacienti ka shprehur vendimin e tij kompetent dhe të mirinformuar që nuk do të pranojë këshilla për të kërkuar një opinion mjekësor, lejohet që të vazhdohet me rekomandimin e sistemeve të përshtatshme të aparateve të dëgjimit duke pasur parasysh konsideratat e mëposhtme:

- Rekomandimi nuk do të ketë efekte negative në shëndetin e pacientit ose mirëqenien e përgjithshme të tij;
- Të dhënat konfirmojnë që janë marrë parasysh të gjitha konsideratat e nevojshme për interesat më të mirë të pacientit



Nëse kërkohet në aspektin ligjor, pacienti ka nënshkruar një deklaratë për mohimin e përgjegjësisë për të konfirmuar që nuk është pranuar këshilla për rekomandim dhe që ky është një vendim i mirinformuar.

#### Përfitimi klinik:

Përmirësimi i të kuptuarit të të folurës

#### Efektet anësore:

Efektet anësore fiziologjike të aparateve të dëgjimit si tinitusi, marramendja, grumbullimi i dyllit, presioni i lartë, djersitja ose lagështia, flluskat, kruajtjet dhe/ose skuqjet, ndjesia e mbushjes dhe bllokimit dhe pasojat e tyre si dhimbja e kokës dhe/ose e veshit mund të zgjidhen nga specialisti juaj audiolog. Aparatet tradicionale të dëgjimit kanë mundësi ta ekspozojnë pacientin ndaj niveleve të larta të ekspozimit ndaj tingujve, gjë që mund të shkaktojë lëvizje të pragut të diapazonit të frekuencave nën efektin e traumës akustike.





## Popullata e synuar e pacientëve

Popullata e synuar e pacientëve janë personat me humbje të lehtë deri në të thellë të dëgjimit (ISO 60115-18) prej moshes 6 muajshe.

Popullata e synuar e pacientëve për veçorinë e softuerit të tinitusit janë personat nga moshë 18 vjeç.

## Përdoruesit e synuar:

Person me humbje të dëgjimit që përdor një aparat dëgjimi dhe kujdestarët e tyre. Specialisti audiolog përgjegjës për rregullimin e aparatit të dëgjimit.





## Informacion i rëndësishëm

- ① Aparati i dëgjimit (sidomos i programuar për humbje të tillë të dëgjimit) duhet të përdoret vetëm nga personi i synuar. Aparati nuk duhet të përdoret nga askush tjetër, pasi përndryshe mund t'u dëmtohet dëgjimi.
- ① Aparati i dëgjimit nuk e rikthen dëgjimin normal dhe nuk parandalon apo përmirëson problemet e dëgjimit që vijnë nga shkaqe organike.
- ① Aparati i dëgjimit duhet të përdoret vetëm sipas udhëzimeve të mjekut të përgjithshëm ose të specialistit audiolog.
- ① Përdorimi i aparatit të dëgjimit është vetëm një pjesë e rehabilitimit të dëgjimit; mund të nevojitet gjithashtu edhe trajnim për dëgjimin, si dhe udhëzime për leximin e buzëve.
- ① Reagimi, cilësia e dobët e tingujve, tingujt shumë të lartë ose shumë të ulët, përshtatja jo e duhur ose problemet gjatë përtypjes ose gëlltitjes mund të zgjidhen ose të përmirësohen gjatë procesit të rregullimit në procedurën e vendosjes së aparatit nga specialisti juaj audiolog.





- ① Në shumicën e rasteve, mospërdorimi i shpeshtë i aparateve nuk ju ofron mundësi të plota. Pasi të jeni ambientuar me aparatën e dëgjimit, mbajeni në vesh çdo ditë gjatë gjithë ditës.
- ① Çdo incident serioz që ka ndodhur në lidhje me pajisjen duhet të raportohet te përfaqësuesi i prodhuesit dhe autoriteti përkatës në shtetin e rezidencës.

Një incident serioz përshkruhet si çdo incident që shkarkon, mund të ketë shkaktuar ose mund të shkaktojë, drejtpërdrejt ose indirekt, një nga sa më poshtë:

- vdekjen e pacientit, përdoruesit ose një personi tjetër
- përkeqësimin serioz të përkohshëm ose të përhershëm të gjendjes shëndetësore të një pacienti, përdoruesi ose personi tjetër
- një kërcënim serioz për shëndetin publik.

Për të raportuar një veprim ose situatë të papritur, kontaktoni me prodhuesin ose një përfaqësues.





## Paralajmërimi

- ⚠ Ky aparat dëgjimi i rikarikueshëm përmban bateri me jone litiumi që mund të merren në avion në bagazhe dore.
- ⚠ Aparati juaj i dëgjimit funksionon në diapazon frekuencash 2,4–2,48 GHz. Kur jeni në fluturim, kontrolloni nëse operatori i fluturimit kërkon që pajisjet të caktohen në modalitetin e fluturimit.
- ⚠ Nuk lejohen ndryshimet apo modifikimet e këtij aparati dëgjimi pa miratimin e shprehur të prodhuesit. Ndryshime të tilla mund t'ju dëmtojnë veshët ose aparatin e dëgjimit.
- ⚠ Mos e përdorni aparatin e dëgjimit dhe aksesoret e karikimit në zona shpërthimi (miniera ose zona industriale me rrezik shpërthimesh, ambiente të pasura me oksigjen ose zona ku përdoren anestetikë të djegshëm), apo aty ku ndalohen pajisjet elektronike.
- ⚠ Nuk pritet të ketë reaksione alergjike ndaj aparatit të dëgjimit. Por, nëse keni kruajtje, skuqje, pezmatim, inflamacion apo ndjesi djegieje brenda apo përreth veshëve, vini në



dijeni specialistin audiolog dhe kontaktoni me mjekun e përgjithshëm.

- ⚠ Në rastet tepër të rralla që ndonjë pjesë e aparatit të dëgjimit mbetet në kanalet e veshëve pas heqjes së aparatit, kontaktoni menjëherë me mjekun.
- ⚠ Programet e dëgjimit në modalitetin e mikrofonit të drejtuar pakësojnë zhurmën e sfondit. Kini parasysh se sinjalet apo zhurmat paralajmëruese që vijnë nga pas, p.sh. automjetet, mbyten pjesërisht ose tërësisht.
- ⚠ Ky aparat dëgjimi nuk është për fëmijë nën 36 muajsh. Përdorimi i kësaj pajisjeje nga fëmijët dhe personat me probleme konjitive duhet të kryhet nën mbikëqyrje të vazhduar, për t'u garantuar sigurinë. Aparati i dëgjimit është pajisje e vogël dhe përmban pjesë të vogla. Mos ua lini pa mbikëqyrje këtë aparat dëgjimi fëmijëve dhe personave me probleme konjitive. Në rast gëlltitjeje, konsultohuni menjëherë me mjekun apo spitalin, pasi aparati i dëgjimit apo pjesët e tij mund të shkaktojnë mbytje.





- ⚠ Mbajeni karikuesin larg fëmijëve, personave me probleme konjitive dhe kafshëve shtëpiake. Nëse e gëlltisni kapsulën tharëse, konsultohuni menjëherë me mjekun ose spitalin.
- ⚠ Mos bëni lidhje me tel nga aparati i dëgjimit me burime të jashtme zëri, si p.sh. radio etj. Mund të pësoni lëndime në trup (elektroshok).
- ⚠ Mos e mbuloni të gjithë karikuesin gjatë karikimit, p.sh. me leckë etj.
- ⚠ Informacioni i mëposhtëm vlen vetëm për personat me pajisje të implantueshme aktive mjekësore (p.sh. stimulues kardiakë, defibrilatorë etj.):
  - Mbajeni aparatin e dëgjimit me valë së paku 15 cm (6 in) larg implantit aktiv.
  - Nëse vëreni ndonjë interferencë, mos e përdorni aparatin e dëgjimit me valë dhe kontaktoni me prodhuesin e implantit aktiv. Kini parasysh se interferenca mund të shkaktohet dhe nga linjat elektrike, shkarkesat elektrostатike, detektorët e metaleve në aeroporte etj.
  - Mbajini magnetet të paktën 15 cm (6 in) larg implantit aktiv.





- Nëse përdorni një aksesor me valë,  
këshillohuni me informacionet e sigurisë në  
udhëzuesin e përdorimit të aksesorit.

- ⚠ Përdorimi i kësaj pajisjeje pranë apo përmbi  
pajisje të tjera duhet evituar, pasi mund të sjellë  
keqfunksionim. Nëse ju duhet ta përdorni në  
mënyrë të tillë, kjo pajisje dhe pajisjet e tjera  
duhet të mbikëqyren për të verifikuar nëse  
punojnë në rregull.
- ⚠ Përdorimi i aksesorëve, konvertuesve dhe  
kabllove të tjera nga ato të përcaktuara apo të  
dhëna nga prodhuesi i kësaj pajisjeje mund të  
shkaktojnë rritje të emetimeve elektromagnetike  
ose rënie të imunitetit elektromagnetik  
të pajisjes duke sjellë funksionim të  
papërshtatshëm.
- ⚠ Pajisjet portative të komunikimit me  
radiofrekuenca (duke përfshirë pajisjet  
periferike si p.sh. kabllot e antenave dhe  
antemat e jashtme) duhet të përdoren së paku  
30 cm (12 in) larg aparatit të dëgjimit, duke  
përfshirë kabllot e rekomanduara nga prodhuesi.  
Përndryshe mund të ketë rënie efikasiteti të  
pajisjes.





- ⚠ Foleja USB-C e karikuesit duhet të përdoret vetëm për qëllimin e përshkruar.
- ⚠ Për karikuesin, përdorni vetëm një pajisje të certifikuar sipas EN60950-1 dhe/ose EN60601-1 me një vlerë nominale dalëse 5 VDC. Min. 500 mA.
- ⚠ Duhet bërë kujdes i veçantë gjatë mbajtjes së aparatit të dëgjimit kur nivelet maksimale të trysnisë zanore tejkalojnë 132 decibelët. Mund të ketë rrezik të dëmtoni dhe pjesën e mbetur të dëgjimit tuaj. Diskutojeni me audiologun tuaj për t'u siguruar që nivelin maksimal i aparatit tuaj të dëgjimit është i përshtatshëm për rastin tuaj të problemit në dëgjim.
- ⚠ Shmangni goditjet e forta fizike në vesh kur mbani një aparat dëgjimi me një kufje të personalizuar. Qëndrueshmëria e kufjeve të personalizuar është planifikuar për një përdorim normal. Një goditje e fortë fizike në vesh (p.sh. në sporte) mund të shkaktojë thyerjen e kufjes së personalizuar. Kjo mund të shkaktojë shpimin e kanalit të veshit ose të daulles së veshit.





- ⚠ Pas një goditjeje ose stresi mekanik ndaj kufjes së personalizuar, sigurohuni që ajo të jetë e padëmtuar para se ta vendosni në vesh.
- ⚠ Pjesa më e madhe e përdoruesve të aparateve të dëgjimit kanë një humbje të dëgjimit për të cilën nuk pritet një përkeqësim i dëgjimit nga përdorimi i rregullt i një aparati dëgjimi në situatat e përditshme. Vetëm një grup i vogël i përdoruesve të aparateve të dëgjimit me humbje të dëgjimit mund të jenë në rrezik për përkeqësim të dëgjimit në periudha të gjata përdorimi.

### Shënim për specialistin audiolog

- ⚠ Gominat nuk duhet të futen kurrë nga klientët me daulle të shpuara të veshit, me zgavra të ekspozuara të veshit të mesëm apo me kanale kirurgjiksht të modifikuara të veshit. Në rast të situatave të tilla, rekomandojmë të përdoret një formë e personalizuar individuale.

### Siguria e produktit

- ① Ky aparat dëgjimi është rezistent ndaj ujit, por jo hermetik. Aparati është krijuar për t'u bërë ballë aktiviteteve normale dhe ekspozimit aksidental ndaj kushteve ekstreme. Mos e





zhytni kurrë aparatin e dëgjimit në ujë. Ky aparat dëgjimi nuk është krijuar specifikisht për të qëndruar për periudha të gjata dhe rregullisht nën ujë, si p.sh. duke e mbajtur gjatë aktiviteteve si noti apo larja. Hiqeni gjithnjë aparatin e dëgjimit përpara këtyre aktiviteteve, pasi aparati përmban pjesë delikate elektronike.

- ① Mos i lani asnjëherë hyrjet e mikrofonit. Ky veprim mund të shkaktojë humbjen e karakteristikave të tyre speciale akustike.
- ① Mbrojeni aparatin e dëgjimit nga nxehtësia (mos e lini kurrë pranë një dritareje apo në makinë). Mos përdorni kurrë mikrovalë apo pajisje të tjera ngrohëse për tharjen e aparatit të dëgjimit (pasi ka rrezik zjarri apo shpërthimi). Pyesni specialistin audiolog për mënyrat e duhura të tharjes.
- ① Mos e vendosni karikuesin pranë një sipërfaqeje gatimi me induksion. Strukturat përcjellëse brenda karikuesit mund të thithin energjinë e induksionit që shkaktohet nga zbërthimi termik.





- ① Gomina duhet të ndryshohet çdo tre muaj ose kur bëhet e ngurtë apo e brishtë. Kjo bëhet për të parandaluar shqitjen e gominës nga gryka e gypit gjatë futjes apo heqjes nga veshi.
- ① Mos e rrëzoni aparatin e dëgjimit. Rënia në sipërfaqe të forta mund ta dëmtojë aparatin e dëgjimit.
- ① Karikuesi dhe ushqyesi duhet të mbrohen nga goditjet. Nëse karikuesi ose ushqyesi dëmtohen nga një goditje, pajisjet nuk duhet të përdoren më.
- ① Mbajeni aparatin e dëgjimit në karikues nëse nuk e përdorni për kohë të gjatë.
- ① Ekzaminimet e posaçme mjekësore apo dentare, ku përfshihet rrezatimi i përshkruar më poshtë, mund të cenojnë funksionimin normal të aparatit të dëgjimit. Hiqni dhe mbajini jashtë sallës/zonës së ekzaminimit përpara se të kryeni:
  - Ekzaminimi mjekësor ose dentar me reze rëntgen (si dhe skaner CT).







- Ekzaminime mjekësore me skaner MRI/NMRI, ku krijohen fusha magnetike.
- Aparati i dëgjimit nuk ka nevojë të hiqet kur kaloni në portat e sigurisë (p.sh. aeroporte etj.). Nëse përdoren rreze rëntgen në çfarëdo rasti, ato do të jenë në doza shumë të vogla dhe nuk ndikojnë në aparatin e dëgjimit.
- ① Mos e përdorni aparatin e dëgjimit ose karikuesin në zona ku ndalohet përdorimi i pajisjeve elektronike.
- ① Aparati i dëgjimit duhet të jetë i thatë përpara vendosjes në karikim. Përndryshe qëndrueshmëria e karikimit nuk garantohet.
- ① Për karikim, përdorni vetëm karikuesin dhe ushqyesin e dhënë nga prodhuesi. Përndryshe pajisjet mund të dëmtohen.
- ① Aparatet tuaja përdorin përbërësit më modern për të ju ofruar kualitetin e zërit më të mirë të mundshëm në çdo situatë dëgjimi. Por pajisjet e komunikimit, si p.sh. celularët, mund të krijojnë interferenca (zhurmë) në aparatin e dëgjimit. Nëse vini re interferenca nga celularët që përdoren pranë jush, mund





t'i pakësoni ato në disa mënyra. Kalojeni aparatin e dëgjimit në një program tjetër, ktheni kokën në drejtim tjetër ose gjeni se ku ndodhet celulari dhe largohuni prej tij.

- ① Këto aparate dëgjimi janë klasifikuar si IP68. Kjo do të thotë që ato janë rezistente ndaj ujit dhe pluhurit, për të përballuar situatat e jetës së përditshme. Ato mund të mbahen nën shi, por nuk duhet të zhyten plotësisht në ujë ose të përdoren kur bëni dysh, kur notoni ose në aktivitete të tjera në ujë. Këto aparate dëgjimi nuk duhet të ekspozohen asnjëherë ndaj ujit me klor, me sapun, ujit të kripur ose lëngjeve të tjera me përmbajtje kimike.
- ① Aparati juaj i dëgjimit përfshin bateri me jone litiumi me një vlerë nominale vatë orë <20 Wh, të cilat janë testuar sipas UN 38.3 nga "Manuali i Kombeve të Bashkuara për testet dhe kriteret" dhe duhet të transportohen në përputhje me të gjithë rregullat dhe rregulloret për transportin e sigurt të baterive me jone litiumi dhe polimere litiumi.





## Vlera nominale e pajtueshmërisë me celularët

Disa përdorues të aparateve të dëgjimit kanë raportuar një gumëzhitje në aparatet e tyre të dëgjimit kur përdorin celularë, që tregon se celulari dhe aparatet e dëgjimit mund të mos jenë të pajtueshme me njëri-tjetrin. Në përputhje me standardin ANSI C63.19 (Metodat e matjes së pajtueshmërisë midis pajisjeve të komunikimit me valë dhe aparateve të dëgjimit, sipas standardit kombëtar amerikan ANSI C63.19-2011), pajtueshmëria e një aparati të caktuar dëgjimi dhe e një celulari mund të parashikohet duke i shtuar vlerën nominale të imunitetit të aparatit të dëgjimit vlerës nominale për emetimet e celularit. Për shembull, shuma e vlerës nominale 4 ( $M_4$ ) të aparatit të dëgjimit me një vlerë nominale 3 ( $M_3$ ) të celularit do të jepnin një vlerë të kombinuar nominale 7. Çfarëdo vlere e kombinuar nominale baras me së paku 5 do të përbënte "përdorim normal"; një vlerë e kombinuar nominale 6 e lart do të përbënte "performancë optimale".

Imuniteti i këtij aparati dëgjimi është së paku  $M_4$ . Matjet e rendimentit të pajisjes, kategoritë dhe klasifikimet e sistemit bazohen mbi informacionin





më të mirë të mundshëm, por nuk garantojnë dot që të përmbushen të gjitha kërkesat e të gjithë përdoruesve.

- ① Rendimenti i aparateve të caktuara të dëgjimit mund të ndryshojë për celularë të caktuar. Ndaj dhe jeni të lutur ta provoni këtë aparat dëgjimi me celularin tuaj ose, nëse jeni duke blerë celular të ri, sigurohuni që ta provoni me aparatën e dëgjimit përpara se ta blini.





## Tinnitus Masker

---

"Tinnitus Masker" përdor zhurmë me brez të gjerë për të dhënë një qetësim të përkohshëm nga tinitusi.

### Paralajmërimet për "Tinnitus Masker"

- ⚠️ "Tinnitus Masker" është një zhurmues me brez të gjerë. Ai bën të mundur terapinë me pasurim tingujsh që mund të përdoret si pjesë e një programi të personalizuar për menaxhimin e tinitusit (zhurmës në veshë), për të ofruar qetësim nga tinitusi.
- ⚠️ Parimi bazë i pasurimit të tingujve është dhënia e stimulimit shtesë me zhurmë, çka mund të ndihmojë në shkëputjen e vëmendjes suaj nga tinitusi duke evituar kështu reagimet negative. Pasurimi i tingujve, së bashku me konsultat udhëzuese, është një qasje funksionale tashmë për menaxhimin e tinitusit.
- ⚠️ Aparatet e dëgjimit me përçim me ajër me "Tinnitus Masker" duhen vendosur nga një specialist audiolog i familjarizuar me diagnostikimin dhe menaxhimin e zhurmës në vesh.





- ⚠ Njëse ju shfaqen efekte anësore gjatë përdorimit të "Tinnitus Masker," si p.sh. dhimbje koke, të vjella, marramendje ose palpitacione kardiake, apo vëreni rënie të funksionit dëgjimor si p.sh. rënie të tolerancës ndaj zërit të lartë, përkeqësim të tinitusit ose të folurit nuk është më aq i qartë, duhet ta ndërprisni përdorimin e pajisjes dhe të kërkonti kujdesin mjekësor.
- ⚠ Volumi i "Tinnitus Masker" mund të caktohet në një nivel që mund dhe të shpjerë drejt dëmtimit të përhershëm të dëgjimit kur përdoret për një kohë të gjatë. Nëse "Tinnitus Masker" është caktuar në nivel të tillë në aparatet tuaja të dëgjimit, specialisti audiolog do t'ju këshillojë për kohëzgjatjen maksimale gjatë ditës kur mund ta përdorni "Tinnitus Masker". "Tinnitus Masker" nuk duhet të përdoret kurrë në nivele jokomode.





## Informacion i rëndësishëm

- ① "Tinnitus masker" krijon tinguj që mund të përdoren si pjesë e një programi të personalizuar për menaxhimin e përkohshëm të tinitusit, për të ofruar qetësim nga tinitusi. Duhet përdorur gjithnjë sipas rekomandimit nga një specialist audiolog i familjarizuar me diagnostikimin dhe trajtimin e zhurmës në vesh.
- ① Praktika e mirë shëndetësore kërkon që personi që raporton për tinitus të marrë një vlerësim mjekësor nga specialisti audiolog i licencuar përpara se të përdorë një pajisje zhurmëkrijuese. Qëllimi i një vlerësimi të tillë është të sigurojë që sëmundjet e trajtueshme nga ana mjekësore, të cilat mund të shkaktojnë tinitusin, të identifikohen dhe të trajtohen përpara përdorimit të pajisjes zhurmëkrijuese.
- ① "Tinnitus Masker" synohet për të rritur të moshave 18 vjeç e lart që kanë edhe humbje të dëgjimit, edhe tinitus.



## 9. Kushtet për përdorimin, transportin dhe ruajtjen

Kjo pajisje është projektuar në mënyrë të tillë që të funksionojë pa probleme apo kufizime nëse përdoret siç pritet, përveçse siç përcaktohet ndryshe në këta udhëzues përdorimi.

Sigurohuni që ta përdorni, ta karikoni, ta transportoni dhe ta ruani aparatin e dëgjimit sipas kushteve të mëposhtme:

	Përdorimi	Karikimi	Transporti	Ruajtja
<b>Temperatura</b> Diapazoni maksimal	+5° deri në +40°C (41° deri në 104°F)	+5° deri në +40°C (41° deri në 104°F)	-20° deri në +60°C (-4° deri në 140°F)	-20° deri në +60°C (-4° deri në 140°F)
Diapazoni i rekomanduar	+5° deri në +40°C (41° deri në 104°F)	+7° deri në +32°C (45° deri në 90°F)	0° deri në +20°C (32° deri në 68°F)	0° deri në +20°C (32° deri në 68°F)
<b>Lagështia</b> Diapazoni maksimal	0% deri në 85% (jokondensuese)	0% deri në 85% (jokondensuese)	0% deri në 70%	0% deri në 70%
Diapazoni i rekomanduar	0% deri në 60% (jokondensuese)	0% deri në 60% (jokondensuese)	0% deri në 60%	0% deri në 60%
<b>Trysnia atmosferike</b>	500 hPa deri në 1060 hPa	500 hPa deri në 1060 hPa	500 hPa deri në 1060 hPa	500 hPa deri në 1060 hPa



## 10. Informacion dhe shpjegimi i simboleve



Me simbolin CE, Sonova AG konfirmon se ky produkt, duke përfshirë aksesoret, përmbush kërkesat e Rregullores për pajisjet mjekësore MDR 2017/745 si dhe të Direktivës për radiopajisjet 2014/53/BE.

Numrat pas simbolit CE përkojnë me kodin e institucioneve të certifikuara që janë konsultuar sipas direktivave të lartpërmendura.



Ky simbol tregon se produktet e përshkruara në këto udhëzime përdorimi janë në pajtim me kërkesat për pjesë të aplikuara të tipit "B" të standardit EN 60601-1. Sipërfaqja e aparatit të dëgjimit përcaktohet si pjesë e aplikuar e tipit B.



Tregon prodhuesin e pajisjes mjekësore, siç përcaktohet në Rregulloren për pajisjet mjekësore (BE) 2017/745.



Tregon përfaqësuesin e autorizuar në Komunitetin Evropian. Përfaqësuesi në Komunitetin Evropian është po ashtu importuesi në Bashkimin Evropian.



Ky simbol tregon se është e rëndësishme që përdoruesi të lexojë dhe të marrë parasysh informacionet përkatëse në këta udhëzues përdorimi.



Tregon se pajisja është një pajisje mjekësore.



Tregon numrin e katalogut të prodhuesit që të mund të identifikohet pajisja mjekësore



Ky simbol tregon se është e rëndësishme që përdoruesi të lexojë dhe të marrë parasysh informacionin përkatës në këtë udhëzues përdorimi.



Ky simbol tregon se është e rëndësishme që përdoruesi t'u kushtojë vëmendje deklaratave përkatëse paralajmëruese në këtë udhëzues përdorimi.



Informacion i rëndësishëm për administrimin dhe përdorimin efikas të produktit.



Simboli i të drejtave të autorit



Simboli me koshin e mbivendosur me kryq përdoret për t'ju bërë me dije se kjo pajisje nuk duhet të hidhet si mbeturinat e zakonshme shtëpiake. Pajisjet e vjetra apo të papërdorura hidhini në pikat e posaçme të hedhjes së mbetjeve elektronike, ose dorëzohani pajisjen tuaj specialistit audiolog për ta hedhur. Hedhja e duhur mbron mjedisin dhe shëndetin.



Fjala e markës dhe logot e Bluetooth® janë marka tregtare të regjistruara në pronësi të Bluetooth SIG, Inc. dhe çdo përdorim i markave të tilla kryhet nën licencë. Markat e tjera tregtare dhe emrat e tjerë tregtarë janë sipas zotëruesve të tyre përkatës.

## IP68

Klasifikimi IP = Klasifikimi i mbrojtjes së hyrjes. Klasifikimi IP68 tregon se aparati i dëgjimit është rezistent ndaj ujit dhe pluhurit. Ai ka mbijetuar në një zhytje të vazhdueshme në 1 metër ujë për 60 minuta dhe 8 orë në një dhomë me pluhur sipas standardit IEC60529



Data e prodhimit



Numri i serisë



Kufizimi i temperaturës për transportin dhe ruajtjen



Kufizimi i lagështisë për transportin dhe ruajtjen



Kufizimi i trysnisë atmosferike për transportin dhe ruajtjen



Mbajeni të thatë



Ky simbol tregon se interferenca elektromagnetike nga pajisja është nën kufijtë e miratuar nga Komisioni Federal i Komunikimeve në Shtetet e Bashkuara.



---

## Simbolet e zbatueshme vetëm për ushqyesin në Evropë

---



Ushqyesi me izolim të dyfishtë

---



Pajisja është projektuar vetëm për përdorim në ambiente të brendshme.

---



Transformator izolues për sigurinë, i mbrojtur nga qarku i shkurtër

---



## 11. Informacioni i pajtueshmërisë

### Deklarata e konformitetit

Sonova AG deklaron nëpërmjet këtij dokumenti se ky produkt përmbush kërkesat e Rregullores për pajisjet mjekësore MDR 2017/745 dhe është në përputhje me Direktivën për radiopajisjet 2014/53/BE. Teksti i plotë i Deklaratave të konformitetit të BE-së mund të merret nga prodhuesi nëpërmjet adresës së mëposhtme të internetit: <https://www.hansaton.de/en/declarations-of-conformity>.

### Australi/Zelandë e Re:



Tregon pajtimin e një pajisjeje me përcaktimet rregulatore të Administratës së Radiospektrit (RSM) dhe të Autoritetit të Medias dhe Komunikimit të Australisë (ACMA) për shitje të ligjshme në Zelandën e Re dhe në Australi. Etiketa e pajtueshmërisë R-NZ është për radioproduktet e furnizuara në tregun e Zelandës së Re sipas nivelit A1 të konformitetit.

### Shënim 1

Kjo pajisje pajtohet me pjesën 15 të rregullave të FCC dhe me RSS-210 të "Industry Canada". Përdorimi u nënshtrohet dy kushteve të mëposhtme:

- 1) kjo pajisje nuk duhet të shkaktojë interferencë të dëmshme; dhe
- 2) kjo pajisje duhet të pranojë çfarëdo interference të marrë, duke përfshirë interferencat që mund të shkaktojnë funksionim të padëshirueshëm.

### Njoftimi 2

Ndryshimet ose modifikimet të bëra në këtë pajisje që nuk janë miratuar shprehimisht nga Sonova AG mund ta bëjnë të pavlefshëm autorizimin e FCC-së për përdorimin e kësaj pajisjeje.



### Njoftimi 3

Kjo pajisje është testuar dhe ka rezultuar në pajtim me kufijtë për pajisje dixhitale të klasit "B", në përputhje me pjesën 15 të rregullores së FCC dhe ICES-003 të "Industry Canada". Këta kufij janë krijuar për të ofruar mbrojtje të arsyeshme kundrejt interferencave të dëmshme në instalime në ambiente banimi. Kjo pajisje krijon, përdor dhe mund të rrezatojë energji radiofrekuece dhe, nëse nuk instalohet e përdoret në përputhje me udhëzimet, mund të shkaktojë interferencë të dëmshme në radiokomunikime. Por nuk ka garanci se nuk do të ndodhë interferencë në instalime të caktuara. Nëse pajisja shkakton interferencë të dëmshme në marrjen e radios apo të televizorit, diçka që mund të përcaktohet duke e fikur dhe rindezur pajisjen, përdoruesit i sugjerohet të provojë ta zgjidhë interferencën me një a më shumë prej masave të mëposhtme:

- Riorientim apo ndryshim të vendit të antenës marrëse
- Rritje të distancës midis pajisjes dhe marrësit
- Lidhje të pajisjes në një prizë të një qarku tjetër nga ai ku është lidhur marrësi
- Konsultim për ndihmë me shitësin apo një teknik radioje/televizori me përvojë



### **Informacioni i radiolidhjes së aparatit të dëgjimit me valë**

Lloji i antenës	Antenë me qark rezonant
Frekuenca e punës	2,4–2,48 GHz
Modulimi	GFSK, Pi/4 DQPSK, GMSK
Fuqia e rrezatuar	<2,5 mW

### **Bluetooth®**

Rrezja	~1 m
Bluetooth	4.2 Dual-Mode
Profillet e mbështetura	HFP (profili i përdorimit pa duar), A2DP

### **Pajtimi me standardet e emetimit dhe të imunitetit**

Standardet e emetimit	EN 60601–1-2
	IEC 60601–1-2
	EN 55011
	CISPR11/AMD1
	CISPR22
	CISPR32
	ISO 7637-2
	CISPR25
	EN 55025

**Standardet e imunitetit**

EN 60601-1-2

IEC 60601-1-2

EN 61000-4-2

IEC 61000-4-2

EN 61000-4-3

IEC 61000-4-3

EN 61000-4-4

IEC 61000-4-4

EN 61000-4-5

IEC 61000-4-5

EN 61000-4-6

IEC 61000-4-6

EN 61000-4-8

IEC 61000-4-8

EN 61000-4-11

IEC 61000-4-11

IEC 60601-1 (§ 4.10.2)

ISO 7637-2







## Vërejtjet tuaja

Regjistroni nevojat tuaja specifike ose shqetësimet dhe sillini ato në zyrë në vizitën e parë pasi t'i merrni aparatet e dëgjimit

Kjo ndihmon që specialisti audiolog t'ju japë zgjidhje për nevojat tuaja.

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_







Dhe importuesi për Bashkimin Evropian:


Sonova Deutschland GmbH

Max-Eyth-Str. 20

70736 Fellbach-Oeffingen, Germany

Pat. [www.sonova.com/en/intellectualproperty](http://www.sonova.com/en/intellectualproperty)





029-6518-90/V1.00/2021-11/CZ © 2020 Sonova AG. All rights reserved.



Prodhuesi:  
Sonova AG  
Laubisrütistrasse 28  
CH-8712 Stäfa  
Switzerland  
[www.hansaton.com](http://www.hansaton.com)

